



*Leading the way
in Customer Interaction
& Process Management.*

Policy Whistleblowing* Grupi Comdata

Miratuar nga Bordi i Drejtorëve të Comdata Spa
05 Mars 2021

*Politika e Bilbilfryësve- shën. Përkth

Indeksi i përmbajtjes

Hyrje	2
1. Qëllimi	3
2. Fusha e zbatimit	5
3. Destinacioni i procedurës	7
4. Përkufizimi i “sinjalizimit”	9
5. Mbrojtja e sinjalizuesit	11
6. Përkufizime	13
7. Sinjalizimi i paligjshëm	16
8. Mënyrat operative	18
8.1. Platforma e historikëve	19
8.2. Praktika e menaxhimit të sinjalizimit	20
8.2.1. Verifikimi paraprak	21
8.2.2. Faza hetimore	24
8.2.3. Marrja e masave	24
9. Raportimi	26
10. Mbrojtja e të dhënave personale	28
Shtojca 1	30

Hyrje

Ky instrument normativ (në vijim "Policy") rregullon procesin e marrjes, analizës, dhe përpunimit të denoncimeve apo sinjalizimeve të dërguara ose të përcjella nga gjithsecili edhe në mënyrë konfidenciale ose anonime dhe që kanë si objekt shkeljen e parimeve etike e të sjelljes të parashikuara nga Kodi Etik i Grupit Comdata ose kryerjen e veprave penale që mund të sjellin përgjegjësi administrative/penale për shoqërinë.

Procedura i përgjigjet veprimeve të parashikuara nga praktikant më të mira referuese në fushën e Governance, Risk & Compliance dhe gjithashtu përmendet konkretisht nga normat dhe rregulloret në fuqi në shumë vende ku operojnë shoqëritë e Grupit Comdata¹.

Ky dokument përfshihet në kontekstin më të gjerë të "Comdata Compliance Program" ("CCP") që është prezantuar nga Grupi Comdata për harmonizimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të krijuar pranë personave të ndryshëm juridikë Comdata dhe për të nxitur sjellje etike nga ana e Personelit Comdata.

CCP përkthehet në zbatimin dhe përditësimin e procedurave të brendshme me qëllim parandalimin e shkeljes së ligjit, të rregulloreve, kodeve të sjelljes, politikave të Grupit, si dhe të Kodit Etik të Grupit, pra, indirekt, të sanksioneve, humbjeve financiare ose dëmtimit të reputacionit.

¹ Për ilustrim, përmendim për Italinë, Dekretin legjislativ nr. 231/2001, Kodi i Vetëdisiplinimit i Bursës Italiane; për Spanjën la Ley Orgànica nr. 5/2010; për Francën, la Loi n. 2016-1691 "Loi Sapin II" përveç se janë instrumenta thelbësore normash për disiplinimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të luftës ndaj korrupsionit (për shembull: Sarbanes-Oxley e Foreign Corrupt Practices Act - (FCPA) në SHBA.

11

Qëllimi



Në mënyrë që të lehtësojë dërgimin e sinjalizimeve, Grupi Comdata ve në dispozicion shumë kanale të transmetimit siç përshkruhet në paragrafin 8 si më poshtë, të cilat lejojnë dërgimin e sinjalizimeve, si në mënyrë elektronike, ashtu dhe në letër. Të gjitha sinjalizimet për sjellje që konsiderohen të papërshtatshme shqyrtohen me kujdes dhe ndihmojnë Shoqërinë e interesuar të marrë masat e duhura, pavarësisht nëse ato janë të nënshkruara ose anonime.

Por, është e rëndësishme që të sigurohen elementë sa më të detajuar, në mënyrë që kontrollet mbi atë çfarë sinjalizohet të mund të kryhen efektivisht nga organet e brendshme kompetente.

Një ndërmarrje padyshim që nuk i ka mjetet e hetimit që autoritetet hetuese mund të përdorin me ligj. Kushdo që synon të dërgojë një sinjalizim është i ftuar të japë elemente të verifikueshëm për të na ndihmuar me qartësimet përkatëse. Përndryshe sinjalizimi do të rrezikonte të ishte joefektiv: një akuzë e thjeshtë, një tregues

i përgjithshëm i sjelljeve që konsiderohen jo korrekte, por pa elementët që kjo të mund të verifikohet dhe të merren masat përkatëse.

Vendimi për nënshkrimin e sinjalizimit është personal. Nëse nënshkruhet, ai do të lejojë organet e brendshme përgjegjëse për verifikimet të kontaktojnë sinjalizuesin për të marrë dhe sqaruar të gjithë elementët e mundshëm shtesë, në mënyrë që t'i bëjë kontrollet potencialisht më të shpejta dhe efikase. Konfidencialiteti i identitetit të sinjalizuesit, do të garantohet gjithmonë në respektim të ligjit, duke e mbajtur emrin e tij të veçuar nga përmbajtja e Sinjalizimit, qysh nga fillimi i përpunimit.

Kriteret e paraqitura këtu gjejnë zbatim edhe për sinjalizimet që vijnë nga personat jashtë Grupit, si dhe nga punonjësit.

2/

Fusha e zbatimit



Policy zbatohet për Comdata SpA.

Ajo, është gjithashtu, referim për të gjitha Shoqëritë e Grupit që angazhohen për ta pranuar me vendimin e Organit të vet administrativ².

Në çdo rast, kur marrin një sinjalizim në kuadrin e procedurave autonome të Whistleblowing të miratuara eventualisht, Shoqëritë e interesuara të Grupit duhet:

- / t'i dërgojnë për dijeni funksionit Internal Audit Comdata Group sinjalizimet e marra;
- / t'i komunikojnë funksionit Internal Audit Comdata Group vlerësimet e kryera për sinjalizimet dhe veprimet e mundshme të ndërmarra.

Menaxhimi i sinjalizimeve dhe përpunimi përkatës i të dhënave bëhet nga Comdata SpA edhe në interes të shoqërive të kontrolluara në respektim të dispozitave ligjore të zbatueshme, përfshirë këtu, në mënyrë të veçantë, parimet e nevojës, të proporcionalitetit dhe ligjshmërisë së trajtimit, sikurse parashikohet nga Rregullorja (BE) 2016/679 për mbrojtjen e personave fizikë, për sa i përket tajtimit të të dhënave personale (GDPR).

Në çdo rast, respektohet autonomia operative dhe menaxheriale e shoqërive të kontrolluara dhe sigurohen kërkesat e konfidencialitetit të nënkuptuara për zhvillimin e veprimtarisë hetimore.

² Në fazën e marrjes, organi kompetent administrativ ka të drejtën dhe përgjegjësinë të marrë parasysh dhe të harmonizojë çdo dispozitë rregullatore lokale pa zvogëluar sidoqoftë, efektivitetin dhe qëllimet e kësaj procedure dhe - në rast të mbivendosjes - të miratojë kriteret më kufizuese midis rregulloreve lokale dhe politikave të Grupit

3/

*Destinacioni
i Procedurës*



Kjo procedurë është e destinuar për:

- a) ortakët dhe administratorët e shoqërive që janë pjesë e Grupit Comdata;
- b) gjithë Personelin që vepron dhe bashkëpunon me shoqëritë e Grupit Comdata në bazë të marrëdhënieve të punës në varësi dhe/ose të bashkëpunimit;
- c) klientët dhe furnizuesit e shoqërive të Grupit Comdata;
- d) palët e treta në përgjithësi.

Për këtë qëllim, Procedura është përhapur dhe është bërë e disponueshme në pikat e mëposhtme të kontaktit dhe komunikimit të shoqërive të Grupit Comdata: në faqen internet, në intranetin e ndërmarrjes, në portalin e vendosur në dispozicion për përpilimin e sinjalizimeve në adresën <https://whistleblowing.comdatagroup.com>.

Për qëllime të zbatimit të kësaj procedure, nënkuptojmë me:

/ funksion lokal përgjegjës për kontrollin e brendshëm entin e ndërmarrjes përgjegjës për të mbikëqyrur funksionimin e duhur të sistemit të brendshëm të kontrollit të një shoqërie (legal entity).

Në rastet kur një legal entity nuk e ka një ent të tillë, i referohet funksionit lokal përgjegjës për kontrollin e brendshëm të shoqërisë kontrolluese më të afërt;

/ funksioni Internal Audit Comdata Group funksioni Internal Audit i shoqërisë Comdata SpA Identifikimi i saktë i funksioneve të mësipërme përmbushet me publikimin e **Shtojcës 1**.

4/

*Përkufizimi
i "sinjalizimit"*



Bëjnë pjesë në përkufizimin e “sinjalizimit”, të përmendur në këtë Procedurë, komunikimet që kanë për objekt sjelljet – reale ose të prezumuara – që i referohen subjekteve që operojnë në emër e për llogari, ose edhe vetëm në interes të Grupit Comdata, të kryera në shkelje të:

- i.** Ligjeve, Rregulloreve, Vendimeve të Autoritetit;
- ii.** Kodit Etik të Grupit Comdata;
- iii.** Modeleve të Organizatës dhe Menaxhimit të miratuara nga shoqëritë e Grupit Comdata në përputhje me dispozitat rregulluese lokale dhe/ose të çdo modeli tjetër ose sistemi Compliance të ndërmarrjes të miratuar nga organi administrativ;
- iv.** të sistemeve menaxheriale, të miratuara nga shoqëritë e Grupit Comdata në bazë të normave ISO.

Nuk konsiderohen “sinjalizime” - për qëllime të zbatimit të kësaj Policy- komunikimet e ndryshme nga rastet e përshkruara më sipër dhe në veçanti ato që u referohen kërkesave, reklamimeve ose ankesave në lidhje me aktivitetet tregtare. Komunikime të tilla,

nëse merren, do t’u dërgohen funksioneve kompetente të ndërmarrjeve për t’i përpunuar ato në bazë të dispozitave të referencës.

Për t’u konsideruar si duhet, “sinjalizimi” duhet:

- a) të kryhet në mirëbesim. Komunikimet e bëra thjesht me qëllim shpifjen, ose delegjitimimin e palëve të treta nuk janë të pranueshme (shih më poshtë: “sinjalizimi i paligjshëm”);
- b) të jetë i saktë dhe i detajuar për faktet e përmendura. Nuk i kërkohet sinjalizuesit që të konstatojë paraprakisht plotësinë dhe sigurinë e fakteve të denoncuara; megjithatë, komunikimi, në mënyrë që të verifikohet dhe vlerësohet, nuk mund të formulohet në një mënyrë abstrakte dhe pa referenca konkrete për kërkime, por duhet të përmbajë një shkallë të mjaftueshme të detajeve për të lejuar konkretisht, në bazë të mjeteve të hetimit në dispozicion, organet kompetente të kompanive për të verifikuar bazueshmërinë ose jo të fakteve ose rrethanave të raportuara.

5/

*Mbrojtja
e sinjalizuesit*



“Sinjalizimi” bëhet – preferohet – në mënyrë të shprehur nëpërmjet komunikimit të njëkohshëm të të dhënave dhe adresave të subjektit sinjalizues.

Të gjithë Personat e Grupit Comdata që marrin një “sinjalizim” dhe/ose që përfshihen, me çfarëdo cilësie, në hetimin dhe trajtimin e tij, kanë detyrimin e garantimit të konfidencialitetit maksimal për subjektet dhe faktet e sinjalizuara, duke aplikuar, për këtë qëllim, kritere dhe mënyra komunikimi të përshtatshëm për të mbrojtur identitetin dhe dinjitetin e personave të përmendur në “sinjalizime”, si dhe anonimatit e të dhënave të identitetit të sinjalizuesve, duke shmangur në çdo rast komunikimin e të dhënave të marra subjekteve të huaj në procesin e hetimit dhe trajtimin të “sinjalizimeve” të rregulluara në këtë Procedurë.

Ligji dhe Kodi i Etikës i Grupit Comdata sigurojnë mbrojtjen maksimale të sinjalizuesit nga çdo sanksion ose hakmarrje kundër tij, duke parashikuar dënime konkrete për kompaninë dhe për ata që zbatojnë ndonjë sjellje që synon

diskriminimin e sinjalizuesit për arsye që lidhen me sinjalizimet.

Në raste të tilla, verifikohen aktet dhe vendimet që lidhen me çdo sanksion, ulje në detyrë, shkarkime, transferime dhe çdo masë tjetër organizative që mund të ketë një efekt negativ në kushtet e punës së sinjalizuesit.

Në mënyrë që të inkurajohet bashkëpunimi komunikues për mbrojtjen më të gjerë të Comdata Group dhe njerëzve që bashkëpunojnë me të, “sinjalizimi” mund të bëhet gjithashtu në mënyrë “anonime” në rast se gjeneralitetet e sinjalizuesit nuk janë të shprehura dhe as të identifikueshme në mënyrë të njëkuptimtë.

Për këtë qëllim, Grupi Comdata ka aktivizuar kanale të shumta komunikimi në mënyrë që të lehtësojë rrjedhat e komunikimit dhe, në të njëjtën kohë, të maksimizojë shkallën e mbrojtjes për sinjalizuesit.

6/

Përkufizime



Termi	Përshkrimi
Comdata	Comdata S.p.A.
Bordi Drejtues ose BD	Bordi Drejtues i Comdata SpA
Internal Audit Comdata Group	Internal Audit i Comdata SpA
Grupi Comdata	Comdata SpA dhe Shoqëritë e kontrolluara prek kësaj të fundit direkt ose indirekt.
Ekipi i Sinjalizimeve	Departament kolegjal – gjendet brenda Drejtorisë Internal Audit të Comdata SpA – përgjegjës për verifikimet paraprake të marrjes, monitorimit dhe koordinimit të veprimeve hetimore të organeve kompetente të mbikëqyrjes dhe kontrollit pranë legal entities të veçanta të Grupit Comdata, si dhe nxitës i veprimeve të nevojshme të informimit dhe trajnimit për individët e kompanisë. Përbëhet nga Drejtori dhe nga Deputy Manager Internal Audit Comdata Group.
Koordinatori i Ekipit të Sinjalizimeve	Përfaqësohet nga Drejtori Internal Audit, që udhëheq end-to-end procesin e menaxhimit të sinjalizimeve, nga marrja e tyre deri tek mbyllja e hetimeve. Ka cilësinë e përfaqësimit - në rast nevoje - Team në takimet me Organet e Adminsitrimin, Menaxhimit dhe Kontrollit.
Regjistri i sinjalizimeve dhe i personave të autorizuar	Regjistri i mbajtur nën përgjegjësinë e Ekipit të Sinjalizimeve që përmban listën kronologjike të sinjalizimeve të trajtuara dhe të personave të autorizuar herë pas here – në bazë të kriterit “need to know” - për të mësuar ekzistencën dhe/ose përmbajtjen e një sinjalizimi dhe identitetin e të Sinjalizuarve, si dhe - kur ligji e lejon – të Sinjalizuesve.
Modeli 231	Modeli i Organizimit, Menaxhimit dhe Kontrollit (në bazë të Dekretit Legjislativ nr. 231 të vitit 2001) miratuar nga BD i Comdata SpA, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale sipas Dek.Legj. nr. 231/2001 vetëm në Comdata SpA.

Termi	Përshkrimi
Kodi Etik	Kodi Etik i Grupit i përkufizuar nga Comdata SpA dhe i pranuar nga të gjitha Shoqëritë e Grupit, i cili identifikohet si bërthama thelbësore e vlerave që përbëjnë kulturën e ndërmarrjes dhe që përkthehen në parime e politika menaxheriale që udhëheqin veprimet e përditshme.
Organi i Mbikëqyrjes ose OM	Nënkuptohehet Organi i Mbikëqyrjes i krijuar në bazë të nenit 6 të Dekretit Legj nr. 231 të vitit 2001, përgjegjës për mbikëqyrjen e funksionimit, të efikasitetit, të respektimit të Modelit dhe për përditësimin përkatës të Comdata SpA.
Policy Antikorrupsion	Policy Antikorrupsion e Grupit Comdata.
Sinjalizimi	Komunikimi që ka për objekt fakte që konsiderohet se mund të jenë: sjellje të paligjshme ose parregullsi; shkelje e normave; akte që shkaktojnë dëmtim pasurie ose imazhi të kompanisë; shkelje të Kodit Etik; shkelje të Politikës Antikorrupsion; shkelje e Kodit Etik të Privatësisë, shkelje të Modelit 231; shkelje të procedurave dhe dispozitave të kompanisë.
Sinjalizuesi	Çdo subjekt (i brendshëm ose jashtë Grupit Comdata) që bën Sinjalizimin, kur vihet në dijeni të informacioneve mbi temat e mësipërme.
I Sinjalizuar	Çdo subjekt të cilit i referohen ose janë të referueshme faktet objekt i një sinjalizimi.

71

Sinjalizmi i paligjshëm



Është i paligjshëm “sinjalizmi” i cili
– nga rezultatet e fazës hetimore
– del i pabazuar në elementë
objektivë, dhe për të cilin rrethanat
konkrete të vërtetuara gjatë këtyre
hetimeve mundësojnë gjykimin
se është bërë në keqbesim ose
me neglizhencë të rëndë.

Në këtë rast, sinjalizuesi
i nënshtrohet masës së sanksionit,
në bazë e për efekt të Sistemit
Disiplinor të Grupit Comdata.

8/

*Modalitetet
operative*



Grupi Comdata, me qëllim lehtësimin e marrjes së sinjalizimeve, ka aktivizuar shumë kanale komunikimi.

Denoncimi i shkeljes mund të dërgohet me:

/ postë të zakonshme;

/ postë elektronike;

/ platformën whistleblowing.

Me publikimin e Shtojcës 1 të kësaj Procedure, si dhe në intranet-in e kompanisë dhe në faqen e internetit janë bërë të njohura, pranë çdo shoqërie të Grupit Comdata, adresat konkrete që duhet të përdoren.

Monitorimi i funksionimit të kanaleve të mësipërme të komunikimit garantohej nga:

/ **funksioni lokal përgjegjës për kontrollin e brendshëm**, për sa i përket marrjes së komunikimeve me postë të zakonshme dhe me postë elektronike;

/ **funksioni Internal Audit Comdata Group**, për sa i përket marrjes së komunikimeve nëpërmjet platformës whistleblowing.

Të gjitha denoncimet e ardhura për shkelje, edhe jashtë kanaleve të komunikimit të treguar më lart dhe pavarësisht nga ai që i ka marrë dhe nga burimi, duhet t'i dërgohen funksionit lokal përgjegjës për kontrollin e brendshëm.

Funksionet e mësipërme sigurojnë gjithashtu, një shkëmbim reciprok informacionesh dhe komunikimesh me Organet përkatëse të Kontrollit dhe Mbikëqyrjes – nëse janë caktuar – për kryerjen e detyrave përkatëse në kuadrin e kompetencave të dhëna atyre. Funksionet lokale përgjegjëse për kontrollin e brendshëm sigurojnë, gjithashtu një fluks komunikimi periodik për funksionin Internal Audit Comdata Group në lidhje me sinjalizimet e ardhura dhe me rezultatet e hetimeve përkatëse, sipas mënyrave të miratuara midis palëve.

8.1. Platforma whistleblowing

Grupi Comdata ka vënë në dispozicion një platformë në internet për menaxhimin e një kanali komunikimi alternativ sinjalizimesh në krahasim me atë

tradicional dhe të përshtatshëm për të garantuar - madje edhe me metodat informatike - konfidencialitetin e identitetit të sinjalizuesit.

Kjo platformë është jashtë sistemit të Grupit Comdata dhe menaxhohet nga një ofrues i pavarur.

Në kohën e hyrjes për futjen e sinjalizimit, jepet një kod identifikues i sinjalizimit. Përmes këtij kodi do të jetë e mundur që sinjalizuesi të dijë nëse sinjalizimi është marrë përsipër dhe të ofrojë ballafaqime dhe përgjigje për t'u thelluar për informacionin e kërkuar. Platforma nuk gjurmon elementet identifikuese të sinjalizuesit ose detajet e kontaktit, përveçse kur sinjalizuesi i tregon vullnetarisht ato në raport.

8.2. Praktika e menaxhimit të sinjalizimit

8.2.1. Verifikimi paraprak

Pas marrjes së Sinjalizimit, Ekipi e Sinjalizimeve kryen një verifikim marrjeje paraprak me qëllim vlerësimin e procedueshmërisë së praktikës së menaxhimit në lidhje

me përmbajtjen e sinjalizimit dhe adresimin e fazave të mëposhtme të verifikimit:

/ sinjalizimet e papranueshme:

konsiderohen të papranueshme sinjalizimet që nuk i janë referuar Comdata-s, as shoqërive të tjera të Grupit, ose janë të hartuara në mënyrë të pakuptueshme ose vulgare, dukshëm jologjike apo instrumentale. Sinjalizime të tilla arkivohen nga Ekipi i Sinjalizimeve pa i hapur rrugë asnjë iniciative të mëtejshme;

/ sinjalizimet që nuk kanë lidhje:

konsiderohen pa lidhje sinjalizimet me objekt çështje të tjera nga shkelja e pretenduar e parimeve të Kodit të Etikës dhe kryerja e pretenduar e veprave penale (për shembull: ankesat me natyrë tregtare, ankesat e një punonjësi në lidhje me aspektet menaxheriale të situatës së vet të punës, si dhe lajmet për shkelje të mundshme të detyrimeve të marrëdhënies së punës nga një punonjës - mungesa të pajustificuara ose të tjera - etj.) Në raste të tilla, sinjalizimet i dërgohen funksionit kompetent (Tregtar, Burimet Njerëzore, etj.) dhe për qëllimet

e Policy do të konsiderohen të arkivuara nga Ekipi i Sinjalizuesve. Sidoqoftë, strukturat e përfshira duhet të japin një përgjigje për Ekipin e Sinjalizimeve për veprimet e kryera. Konsiderohen gjithashtu pa lidhje sinjalizimet, përmbajtja e të cilave nuk mund të verifikohet për shkak të natyrës së tyre të përgjithshme, duke rezultuar me mungesa ose me pamjaftueshmëri (referenca në fakte, rrethana, njerëz, etj.) të nevojshme për të nisur kontrollet dhe, duke qenë jo i mundur (ose i dobishëm) një kontakt me sinjalizuesin (sinjalizime “jo të detajuara”), ose përmbajtja e të cilave nuk mund të konstatohet me mjetet e verifikimit në dispozicion të një organizate të kompanisë (sinjalizime “jo të verifikueshme”). Këto raporte arkivohen nga Ekipi i Sinjalizuesve, kur nuk është e mundur që ato të bëhen konkrete ose të verifikueshme;

/ sinjalizime të ndërlidhura:

konsiderohen të ndërlidhura sinjalizimet që përmbajnë informacione të tilla që e bëjnë denoncimin mjaft të besueshëm me anë të përmbajtjes së besueshme, të hollësishme dhe të verifikueshme. Këto denoncime dërgohen në fazën e hetimeve.

/ Sinjalizimet 231: janë raporte që kanë për objekt çështje që mund të kenë ndikim në Modelin 231 të Comdata SpA dhe më përgjithësisht në dispozitat e Dekretit Legjislativ nr. 231/2001, ose që kanë lidhje me parimet e Kodit të Etikës për territorin italian. Këto sinjalizime dërgohen në fazën e hetimeve.

Pas vlerësimit të mësipërm, vetëm për sinjalizimet e dërguara në fazën hetimore, Ekipi i Sinjalizimeve shënon sinjalizimin në një Regjistër të veçantë, duke raportuar dhe përditësuar informacionet e mëposhtme, kur është e aplikueshme:

- a) Numrin progresiv hyrës;
- b) Datën dhe kanalën e marrjes;
- c) Shoqërinë e Grupit të interesuar;
- d) Emrin e Sinjalizuesit (kur komunikohet) dhe kodin me numra dhe me shkronja të dhënë atij;
- e) Objektin dhe përmbledhjen e Sinjalizimit;
- f) Llojin e shkeljes së raportuar e të prezumuar;
- g) Përgjegjësin e Hetimit;
- h) Datën e fillimit dhe të zhvillimit të hetimit;
- i) Gjendjen e hetimit;
- j) Rezultatit e hetimit (vlerësimin e procedueshmërisë);

- k) Vendimin e organeve kompetente përgjegjëse për zbatimin e e masave që do të ndërmerren;
- l) Shënimet (e mundshme).

Veprimet e hetimeve paraprake i besohen subjekteve të mëposhtëm (të ngarkuar me veprimet hetimore):

/ OM, për sinjalizimet me objekt çështje që mund të kenë ndikim në Modelin 231 e më në përgjithësi mbi dispozitat e Dekretit Legjislativ nr. 231/2001 ose që kanë të bëjnë me parimet e Kodit Etik në territorin italian;

/ funksioni lokal përgjegjës për kontrollin e brendshëm që ekziston pranë një shoqërie të kontrolluar nga Comdata SpA tek i cili referohet sinjalizimi territorialisht ose pranë shoqërisë më të afërt kontrolluese;

Internal Audit Comdata Group

/ në rastet kur nuk janë të kalueshme rastet e mësipërme.

Për çdo sinjalizim, Ekipi e Sinjalizimeve krijon një dosje të posaçme, kur ruhet dokumentacioni i mbledhur për sinjalizimin, edhe pas diskutimit me subjektet e ngarkuar

me veprimet hetimore paraprake gjatë fazës përkatëse, përfshirë këtu procesverbalet për dëgjimet e mundshme të personave, që mund të kenë informacion për faktet dhe raporti përfundimtar i hetimit.

Të gjithë subjektet e ngarkuar me veprimet hetimore sigurojnë respektimin e parimeve të konfidencialitetit dhe të mbrojtës së të dhënave personale. Gjithashtu, ata mund të shfrytëzojnë, kur gjykohet me vend ose e nevojshme, mbështetjen e konsulentëve të jashtëm për kryerjen e analizës dhe për thellime teknike, fraud investigation, analiza mjeko ligjore, auditime, me të cilët do të nënshkruhen letra të posaçme për dhënie detyre dhe për konfidencialitet.

Subjekti i ngarkuar me veprimet hetimore:

b) si rregull tërhiqet nga shqyrtimi i sinjalizimeve lidhur me fakte për të cilat dihet se ekzistojnë hetime në proces nga ana e Autoriteteve Publike (për shembull: autoritetet gjyqësore, organet e administratës, etj.), dhe për fakte tashmë që dihet se janë objekt i një procesi gjyqësor

- midis një shoqërie të interesuar të Grupit dhe Palëve të Treta ose Punonjësve (të ashtuquajturat sinjalizime “për fakte objekt hetimi/ gjykimi në proces”);
- c) pezullon ose ndërpret hetimin në çdo kohë, nëse konstatohet se denoncimi është i pabazuar dhe, nëse konstatohet keqbesimi i denoncuesit, rezervon të drejtën të paraqesë vlerësimin të strukturat kompetente të shoqërisë për fillimin e një procedimi kundër tij;
- d) në rast se zbulohet kryerja e një veprë penale, përgatit një raport mbi aktivitetin e kryer dhe informon në kohën e duhur Organin Administrativ për vlerësimet kompetente mbi përfshirjen e mundshme të Autoriteteve Gjyqësor dhe - kur janë caktuar - Organet Mbikëqyrëse dhe të Kontrollit të kompanisë specifike;
- e) edhe nëse është jashtë hipotezës së kryerjes së ndonjë veprë penale, komunikon - në përputhje me kriteret e nevojshme të konfidencialitetit - çdo ankesë specifike të marrë, rezultatet e kontrolleve dhe çdo rekomandim të propozuar për të korrigjuar parregullsitë e gjetura tek Menaxheri/ët e Funkcionit/eve të interesuar/a, tek Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Organi Administrativ për miratimin e masave përkatëse që kanë për kompetencë;
- f) arkivon sinjalizimet në lidhje me faktet tashmë të njohura më parë dhe të konstatuara plotësisht nga funksioni lokal përgjegjës për kontrollin e brendshëm dhe/ose nga Internal Audit Comdata Group pa shtuar sinjalizimi, ose pa mundur të shtojë elemente ose aspekteve të mëtejshme për çka dihet (të ashtuquajtura sinjalizime “të tejkaluara”).
- Funksioni lokal i ngarkuar me kontrollin e brendshëm, të paktën çdo tre muaj, i siguron Ekipit të Sinjalizimit përditësimin e dosjeve të hapura, nën hetim dhe të përfunduara me konkluzionet përkatëse.
- Funksioni Internal Audit Comdata Group informon, të paktën çdo gjashtë muaj, Kryetarin e Bordit Drejtues të Comdata SpA, kur është i caktuar Komitetin e Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimin të Riskut, Bordin e Auditëve dhe Organin Mbikëqyrës të emëruar në bazë të Dekretit Legjislativ nr. 231/2001 në lidhje me denoncimet e marra dhe statusin e tyre.

8.2.2. Faza hetimore

Objektivi i fazës së hetimit konsiston në konstatimin e bazueshmërisë së sinjalizimit dhe të shkallës së rëndesës së tij dhe sjell kryerjen e verifikimeve të targetuara në sinjalizimet përkatëse [dhe në sinjalizimet 231] që lejojnë identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e elementëve të mundshëm për të konfirmuar - objektivisht - faktet e raportuara. Në bazë të një vlerësimi kolegjal, Ekipi Sinjalizuesve do të vendosë në mënyrë alternative që:

- a) Të kryejë direkt veprime konstatimi duke gjetur informacione nga funksionet e shoqërisë së prekur nga Sinjalizimi;
- b) Të shfrytëzojë mbështetjen e Strukturave Kompetente të identifikuara herë pas here, për kryerjen e konstatimit duke i ftuar ato që të japin një përgjigje mbi ato çfarë kanë verifikuar;
- c) T'i kërkojnë funksionit përgjegjës për kontrollin e brendshëm kryerjen e veprimeve të nevojshme të konstatimit për analizimin dhe vlerësimin e bazueshmërisë së fakteve të sinjalizuara.

Më pas funksioni përgjegjës për kontrollin e brendshëm i dërgon Ekipit të Sinjalizimeve një relazion të detajuar mbi verifikimet e kryera.

Subjekti i ngarkuar me veprimet hetimore, nëse e gjykon të nevojshme dhe të përshtatshme, me qëllim kryerjen e hetimit, mund të dëgjojë (direkt ose nëpërmjet personave të tretë të ngarkuar posaçërisht) Sinjalizuesin (nëse i është komunikuar emri), ashtu si dhe të Sinjalizuarin dhe subjekte të tjerë që gjykohet se mund të japin informacionet, apo përgjigjet e duhura. Çdo dëgjim shënohet në procesverbal nga një subjekt i ngarkuar me veprimet hetimore.

8.2.3. Marrja e masave

Në fund të aktivitetit të hetimit, Ekipi i Sinjalizimit shënon në Regjistër rezultatet e veprimitarisë së hetimit dhe masat e marra nga organet kompetente të shoqërisë dhe/ose strukturat organizative, duke shënuar arsyetimin përkatës. Në veçanti, masat mund të konsistojnë në:

- a) Kërkimin dhe/ose rekomandimin për Strukturat e interesuara të veprimeve të duhura lidhur me rastin konkret të konstatuar.

Më pas i lihet përgjegjësisë menaxhuese të Strukturës së interesuar vlerësimi i masave të mundshme që do të merren - në lidhje me kuadrin sanksionues në fuqi të shoqërisë së përfshirë të Grupit dhe komunikimi tek Ekipi i Sinjalizimeve për nismat e përpikta të ndërmarra. Vetëm pas këtij komunikimi sinjalizimi mund të konsiderohet i arkivuar (i ashtuquajtur i sinjalizim “i mbyllur me veprim”);

b) Arkivimin e Sinjalizimeve për të cilat nuk është konstatuar ekzistenca e fakteve të sinjalizuara (të ashtuquajturat sinjalizime “të mbyllura pa veprim”).

9/

Raportimi



Ekipi i Sinjalizimeve përgatit një relacion gjashtëmujor për të gjitha sinjalizimet e ardhura dhe për kërkimet e kryera – duke treguar me përpikmëri ato që kanë lidhje - i cili i dërgohet Bordit Drejtues dhe Organeve të Kontrollit të Comdata SpA: Komitetit të

Kontrollit dhe Menaxhimit të Riskut (nëse ka), Bordit të Auditëve dhe Organit Mbikëqyrës. Raportimi në çështjen e sinjalizimeve 231 kryhet vetëm nga Organi i Mbikëqyrjes së Comdata SpA.

10/

*Mbrojtja
e të dhënave
personale*



Në përputhje me parimin e minimizimit sipas nenit 5 të Rregullores (BE) nr. 2016/679 ("GDPR"), mund të trajtohen vetëm të dhënat personale që rezultojnë se i përkasin dhe janë të nevojshme për qëllimet e Policy.

Prandaj, të gjitha të dhënat personale (të çdo personi fizik) të përfshira në Sinjalizim, ose ndryshe të mbledhura gjatë fazës së hetimit që nuk janë të nevojshme do të fshihen ose do të bëhen anonime.

Në informacionin e privatësisë ka informacione të përgjithshme në lidhje me trajtimin e të dhënave personale në kontekstin e Policy.

Gjatë çdo Sinjalizimi, i Raportuari dhe palët e tjera të përfshira në Sinjalizim mund të mos marrin menjëherë një informacion specifik të privatësisë në lidhje me trajtimin e të dhënave të tyre, kur ekziston rreziku që, duke dhënë një informacion të tillë, kompromentohet aftësia për të verifikuar në mënyrë efektive bazueshmërinë e Sinjalizimit ose për të mbledhur reagimet e nevojshme.

Shtojca 1

Adresat që duhen përdorur për përcjelljen e sinjalizimeve

Adresa e postës së zakonshme

Shoqëria: _____

Funksioni lokal përgjegjës për kontrollin e brendshëm: _____

Adresa e zakonshme: _____

Selia: _____

Adresa e postës elektronike

Shoqëria: _____

Funksioni lokal përgjegjës për kontrollin e brendshëm: _____

Adresa e-mail: _____

Shoqëria: _____

Organi i Mbikëqyrjes dhe Kontrollit: _____

Adresa e-mail: _____

Platforma Whistleblowing

<https://whistleblowing.comdatagroup.com>



*Leading the way in Customer Interaction
& Process Management.*